



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 16/5 Prot

Tiranë, më 10.01.2022

V E N D I M

Nr. 1, datë 10.01.2022

“PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDIT TË FINANCUAR NGA BUXHETI I SHTETIT NË FORMËN E GRANTIT PËR VITIN 2022 SIPAS NJËSIVE SHPENZUESE (FAKULTETE) TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, VKM Nr. 75, datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimin e përbashkët Nr. 20 datë 20.09.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, Vendimin e Senatit Akademik Nr. 1, datë 07.01.2022, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 16/4 Prot., datë 07.01.2022, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë ndarjen e fondit prej 905,543,324 (*nëntëqindë e pesëmilion e pesëqindë e dyzetë e tremijë e treqindë e njëzetë e katër*) lekë të financuar nga Buxheti i Shtetit në formën e Grantit për vitin 2022, shpenzime për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore për punonjësit sipas Njësive Shpenzuese të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe të tjera shpenzime sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Të miratojë detajimin e grantit për bursa studenti të ndara sipas Njësive Shpenzuese (fakulteteve) të Universitetit Bujqësor të Tiranës për vitin 2022 (tabela bashkëlidhur).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI

Kryetar

Rjeter GURALUMI

Anëtar

Sokol DURO

Anëtar

Marin MEMA

Anëtar

Fran GJINI

Anëtar

Albert KOPALI

Anëtar

Donika KËRÇINI

Anëtar